



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM**

**Nr. i Dokumentit: 22.11.1-2015-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT**  
**PËR PASQYRAT VJETORE FINANCIARE TË KOMUNËS SË**  
**LIPJANIT PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2015**

**Prishtinë, qershor 2016**

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për t'u kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne po rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe po luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Lipjanit në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrë auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Florim Beqiri, i mbështetur nga Udhëheqësi i Ekipit, Lavdim Maxhuni dhe anëtari i ekipit Edon Kabashi.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	7
2 Qeverisja.....	10
3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.....	16
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit .....	26
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP .....	27
Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak .....	30


## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare të Komunës së Lipjanit për vitin 2015, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Dëshirojmë të falënderojmë Kryetarin e Komunës dhe stafin e tij për ndihmën e tyre të dhënë gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2015 u ndërmor në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat kemi menduar se janë të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me Pasqyrave Vjetore Financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, të datës 12.11.2015.

Auditimi ynë është fokusuar në:



(Më gjerësisht, shih shtojcën I të këtij raporti).

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2015 është përcaktuar nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

### Opinion

Shtojca II shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuar nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm është:

“Opinion i pamodifikuar”

Pasqyrat Vjetore Financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale të pranimeve dhe të pagesave si dhe të buxhetit të realizuar të Komunës së Lipjanit për vitin e përfunduar më 31.12.2015.


Formulimi i plotë i opinionit është dhënë në hollësi te nën kapitulli 1.2 i këtij raporti.

## Konkluzioni i përgjithshëm

Bazuar në detajet e paraqitura në secilën pjesë të këtij raporti, konkluzioni ynë i përgjithshëm është se:

Komuna ka bërë veprime për adresimin e rekomandimeve tona dhe ushtron kontrolle në pjesën më të madhe të sistemit të kontrollit të brendshëm, por ende ekzistojnë disa fusha ku dobësitë janë të pranishme.

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:



Ende ekzistojnë dobësi tek menaxhimi i të hyrave nga dhënia me qira e pronës komunale, ku qiramarrësit vazdojnë ta shfrytëzojnë pronën komunale pa kontrata valide.



Kryetari duhet të siguroj se do ketë monitorim të vazhdueshëm tek dhënia me qira e pronës komunale në mënyrë që qiramarrësit mos t'i shfrytëzojnë pronat komunale pa kontrata (shih çështjen 11)

### **Përgjigja e Menaxhmentit në auditimin 2015**

Kryetari i Komunës ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit në këtë raport, si dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet e dhëna.

Ne e konsiderojmë si të kryer faktin që Kryetari:

- Do ta shqyrtoj raportin e auditimit në Asamblenë Komunale; dhe
- Deri në fund të muajit janar 2017, ta diskutoj në Asamblenë Komunale progresin lidhur me implementimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, para se PVF 2016 të jenë dorëzuar në Ministrinë e Financave.

# 1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

## 1.1 Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PVF. Ne, gjithashtu, shqyrtojmë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur PVF-të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata për prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PVF-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

## 1.2 Opinioni i Auditimit

### PËR KOMUNËN E LIPJANIT

#### OPINIONI I PAMODIFIKUAR

Ne kemi audituar Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Lipjanit për vitin e përfunduar më 31.12. 2015, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale, shënimet shpjeguese të Pasqyrave Vjetore Financiare si dhe shpalosjet.

Sipas mendimit tonë, Pasqyrat Vjetore Financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale, të pranimeve dhe të pagesave si dhe të buxhetit të realizuar të Komunës së Lipjanit për vitin e përfunduar më 31.12.2015, në përputhje me: Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme); Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullën Financiare të Ministrisë së Financave nr. 03/2013/ për Pasqyrat Vjetore Financiare të organizatave buxhetore.

#### Baza për Opinionin

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të Pasqyrave Vjetore Financiare të organizatave Buxhetore në Kosovë, ZAP është i pavarur nga komuna dhe përgjegjësitë e tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

### **Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe personave përgjegjës për Qeverisje dhe Pasqyrat Vjetore Financiare**

Menaxhmenti i komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të PVF sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme, si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të tilla të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e PVF pa keqdeklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr.03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime).

Personat e ngarkuar me qeverisje, si: Kryetari i Komunës, drejtorët, mbajtësit e buxhetit dhe zyrtarët financiar janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të komunës.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare**

Përgjegjësia jonë është që ta shprehim një opinion për Pasqyrat Vjetore Financiare në bazë të auditimit tonë. Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike dhe ta planifikojmë dhe ta kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për atë nëse pasqyrat financiare nuk kanë keqdeklarime materiale.

Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse Pasqyrat Vjetore Financiare në tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi, Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë gjithnjë një keqdeklarim material kur ajo ekziston. Keqdeklarimet mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritet që të ndikojnë vendimet e përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave vjetore financiare.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori e konsideron kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e Pasqyrave Vjetore Financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Auditimi e përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të Pasqyrave Vjetore Financiare.



## 1.3 Rreziqet domethënëse në PVF

### Përshkrimi

Në Memon e planifikimit të auditimit, të datës 12.11.2015, janë identifikuar dy rreziqe për PVF-të. Këto janë rreziqe të keqdeklarimeve materiale, të cilat mund të rezultojnë në modifikim të opinionit ose në theksim të çështjes. Këto kanë të bëjnë me klasifikimin e shpenzimeve në kode adekuate dhe prezantimin e drejtë të pagesave nga palët e treta. Menaxhmenti kishte ndërmarrë veprimet e duhura gjatë vitit 2015 për të siguruar se janë regjistruar drejt shpenzimet në kode adekuate dhe pagesat nga palët e treta janë prezantuar drejt në PVF.

## 1.4 Pajtueshmëria me kërkesat për PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të veproj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese për PVF dhe kërkesat tjera për raportim të jashtëm. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren Financiare MF nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me kërkesat buxhetore;
- Raportimet tremujore në Kuvendin Komunal;
- Planin e prokurimit dhe raportimin e progresit të investimeve kapitale mbi 10,000€; dhe
- Pasqyrat nëntëmujore financiare.

Komuna i kishte përmbushë kërkesat e mësipërme.

Në kontekst të PVF-ve, ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me këto. Çështjet e ngritura në Memon tonë të auditimit të ndërmjetëm, të datës 14.12.2015, në lidhje cilësinë e informatave në PNF dhe kornizën raportuese ishin adresuar nga Menaxhmenti.

## 1.5 Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë

## 2 Qeverisja

### 2.1 Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për komunën që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vetëvlerësimit që plotësohet nga organizatat buxhetore siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një organizatë individuale buxhetore të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes e pasqyron një shqyrtim të:

- Fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku ne besojmë se rekomandimet tona mund të nxisin përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm, dhe
- Fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve siç janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij raporti).

### 2.2 Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston ende hapësirë për t'u përmirësuar aspekti i qeverisjes brenda komunës veçanërisht në lidhje me menaxhimin e rrezikut, cilësinë e raportimit menaxherial dhe sistemin e auditimit të brendshëm. Lista kontrolluese e vetëvlerësimit, e plotësuar nga komuna, e pasqyron këtë situatë vetëm pjesërisht.

## 2.3 Rekomandimet e vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2014 ka rezultuar me 19 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi me zotimin se rekomandimet e dhëna do të adresohen.

Deri në datën e auditimit, tetë (8) rekomandime ishin adresuar plotësisht, tetë (8) janë adresuar dhe janë në proces të implementimit, dhe tri (3) të tjera nuk ishin adresuar fare. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shih Shtojcën III në fund të këtij raporti.

Është për t'u vlerësuar fakti se Raporti i auditimit për PVF e vitit 2014 ishte diskutuar edhe në Kuvendin Komunal me datën 30.07.2015, çka ndikon në rritjen e transparencës dhe shqyrtimin më kritik të aktiviteteve të komunës.

---

### Çështja 1 - Implementimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

**E gjetura** Menaxhmenti ka angazhuar auditorin e brendshëm për t'i përcjellë implementimin e rekomandimeve të vitit të kaluar të dhëna nga ZAP, dhe kjo njësi e ka bërë rishikimin e rekomandimeve dhe ka konkluduar se disa nga rekomandimet vetëm pjesërisht janë adresuar. Andaj nevojitet një qasje e përmirësuar për të adresuar në mënyrë të vazhdueshme të gjitha rekomandimet e dhëna.

Po ashtu, edhe vlerësimet që ne i kemi bërë implementimit të rekomandimeve, nxjerrin në pah se menaxhmenti ka trajtuar shumicën prej tyre dhe ka shënuar progres të mirë, por nevojiten veprime shtesë deri në adresimin e tyre të plotë.

**Rreziku** Disa rekomandime janë duke u përsëritur nga viti i kaluar që tregojnë për dobësi të vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve tjera në sistemet financiare kyçe. Kjo ka rezultuar veçanërisht në:

- Mungesën e verifikimit të 1/3 të pronave komunale tek tatimi në pronë;
- Mungesën e statutit të komitetit të auditimit; dhe
- Mungesën e kontrolleve tek procesi i prokurimit, në veçanti procedura të shpeshta për blerje dhe furnizime me kuotim çmimesh.

**Rekomandimi 1** Kryetari duhet të forcoj masat e kontrollit dhe të përgjegjësisë ndaj personave të ngarkuar për adresimin të plotë rekomandimeve që veprimet e parashikuara me plan veprimi të zbatohen, në veçanti në fushat e identifikuar me shkallë të lartë rreziku dhe brenda afateve të përcaktuara.

---

## 2.4 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të MFK-së

Ministria e Financave (MF) ka hartuar një listë të detajuar të vetë-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vetëvlerësimit të MFK-së të dorëzuara në MF. Më poshtë, ne kemi përmbledhur gjetjet tona për komunën. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vetëvlerësimit por do ta japë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për t'i mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

---

### Çështja 2 - Lista kontrolluese e vetëvlerësimit - Prioritet i lartë

Si pjesë e auditimit tonë, ne kemi shqyrtuar disa çështje kyçe të pyetësorit të vetëvlerësimit në lidhje me disa komponenta. Nga çështjet e shqyrtuara kemi vërejtur se:

1. Komuna ka përgatitur një listë të rreziqeve sipas kërkesave të MFK ku i kishte paraqitur objektivat për secilën drejtori dhe rreziqet potenciale. Ne e vlerësojmë këtë veprim të menaxhmentit, dhe sugjerojmë që veprimet e duhura kundrejt rreziqeve eventuale në vazhdimësi të monitorohen në mënyrë që ato të minimizohen në nivel të pranueshëm dhe kjo është trajtuar në hollësi në nënkapitullin 2.5.1;
2. Komuna ka të hartuar strategjinë e zhvillimit ekonomik lokal 2012-2017, ku është e përfshirë edhe kostoja e strategjisë për projekte kapitale, mirëpo kërkohen procese efektive të monitorimit të kësaj strategjie në mënyrë që sigurohet se po arrihen objektivat e përcaktuara;
3. Adresimi i rekomandimeve të ZAP është trajtuar më në hollësi në nënkapitullin 2.3;
4. Lidhjet në mes të planit të prokurimit dhe buxhetit si dhe përpilimi i raporteve adekuate në baza të rregullta kohore konsiderohen si të vendosura nga komuna dhe dëshmitë që na janë dhënë e mbështesin këtë konkluzion;
5. Auditimi i Brendshëm ka qenë funksional dhe i ka ndihmuar menaxhmentit me rekomandimet e dhëna në fusha të ndryshme kjo është trajtuar në hollësi në kapitullin 2.6; dhe
6. Ekziston një sistem i mirë i raportimit të brendshëm, mirëpo këto raporte nuk i kanë adresuar të gjitha pohimet e auditimit tonë dhe për këtë ne nuk kemi mundur të marrim siguri të mjaftueshme nga Kontrolllet e Nivelit të Lartë të Menaxhmentit.

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## 2.5 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar në planifikimin e auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit komuna operon dhe sfidat me të cilat ajo përballet.

### 2.5.1 Vlerësimi i rrezikut

Të gjitha organizatat buxhetore pritët të zbatojnë vlerësimin e rrezikut. Udhëzimet e përcaktuara kërkojnë që regjistri i rrezikut të jetë i kompletuar për të mbështetur menaxhimin efektiv operacional dhe strategjik të komunës.

---

#### Çështja 3 - Moszbatimi i kërkesave për Menaxhimin e rrezikut - Prioritet i lartë

- E gjetura** Pyetësi i vetëvlerësimit të plotësuar ka vërtetuar se komuna ka përgatitur një listë të rreziqeve sipas kërkesave të MFK-së ku i kishte paraqitur objektivat për secilën drejtori dhe rreziqet potenciale. Ne e vlerësojmë këtë veprim të menaxhmentit, dhe sugjerojmë që veprimet e duhura kundrejt rreziqeve eventuale në vazhdimësi të monitorohen në mënyrë që ato të minimizohen në nivel të pranueshëm. Mirëpo, vërehet mungesa e llogaridhënies tek menaxhmenti i lartë lidhur me menaxhimin e regjistrit të rreziqeve si dhe një mungesë njohurie brenda departamenteve për rolet e tyre në ofrimin e mbështetjes për procesin e menaxhimit të rrezikut. Për menaxhimin efektiv të rrezikut nevojiten veprime të qarta, të cilat duhet të zbatohen për të gjitha rreziqet domethënëse që kanë ndikim tek organizata.
- Rreziku** Mungesa e një procedure formale dhe të dokumentuar të adresimit të rreziqeve në organizatë do të reduktoj aftësinë e menaxhmentit për reagime të shpejta në evitimin e rreziqeve të shfaqura.
- Rekomandimi 2** Kryetari duhet të sigurojë se do krijohen procedura formale për menaxhimin e rrezikut për organizatën në mënyrë, të përcaktoj dhe ndërmerr veprimet e nevojshme nëse ato ndodhin, si dhe t'i monitoroj në mënyrë sistematike.

## 2.5.2 Raportimi Menaxherial

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

---

### Çështja 4 – Dobësi në Kontrollat Menaxheriale – Prioriteti i lartë

- E gjetura** Pas rishikimit të kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin financiar kryesor të komunës është vërejtur se ekzistojnë një sistem i mirë i raportimit të brendshëm, mirëpo këto raporte nuk i kanë adresuar të gjitha pohimet që ndërliken me PVF dhe për këtë ne nuk kemi mundur të marrim siguri të mjaftueshme nga Kontrollat e Nivelit të Lartë të Menaxhmentit, për kategoritë ekonomike: të hyrat, mallrat dhe shërbimet, investimet kapitale, subvencione dhe transfere.
- Rreziku** Mungesa e informatave të nevojshme për tu mbështetur në raportet e drejtorive që dërgohen tek Kryetari i Komunës, redukton aftësinë e menaxhmentit për të drejtuar në mënyrë efektive aktivitetet e komunës, për të reaguar ndaj sfidave financiare në kohën e duhur dhe për të zbatuar kontrollin efektiv të buxhetit.
- Rekomandimi 3** Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme.

## 2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) operon vetëm me drejtorin e njësisë. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës i cili reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të komunës dhe të ofroj siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja dhe sfidat e ofruara nga një Komitet efektiv Auditimi.

---

### Çështja 5 – Funkcionimi i NJAB-it dhe komitetit të auditimit – Prioriteti i mesëm

**E gjetura** Njësia e Auditimit të brendshëm për 2015 kishte planifikuar shtatë auditime, dhe kishte arrit që t'i përfundojë të gjitha. Auditimet e kryera nga NJAB kishin të bënë me aktivitetet e vitit 2014 dhe 2015. NJAB kishte bërë një punë të mirë duke audituar fusha me rrezik të lartë, siç janë: Të hyrat, Personeli, Prokurimi, Menaxhimin e pasurisë.

Ne vlerësojmë punën e bërë nga kjo njësi dhe mund të konkludojmë se raportet ishin cilësore dhe të dëshmuara në mënyrë adekuate, ku kishin mbuluar aktivitete në proces, duke arritur të identifikojnë disa nga mangësitë në sistemet e kontrollit të brendshëm të komunës. Rekomandimet e NJAB-së vetëm pjesërisht ishin implementuar.

Nevojitet një punë më cilësore dhe më e theksuar e komitetit në drejtim të nxitjes së implementimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, nga menaxhmenti i komunës. Po ashtu, komiteti i auditimit akoma nuk e ka hartuar statutin që përcakton objektivat dhe fushëveprimin e tij.

Komiteti i auditimit gjatë viti kishte mbajtur katër takime ku ishte diskutuar implementimi i rekomandimeve të ZAP dhe NJAB.

**Rreziku** Mos adresimi i plotë i rekomandimeve të NJAB reflekton edhe efektin e komitetit të auditimit drejt nxitjes së këtij procesi dhe rritë rrezikun që mangësitë e identifikuar të përsëriten vazhdimisht, dhe në të ardhmen, ato mund të bëhen edhe më të theksuara.

**Rekomandimi 4** Kryetari duhet edhe më tutje të fuqizoj mekanizmat që rekomandimet e NJAB, të adresohen dhe të siguroj se komiteti i auditimit është vazhdimisht aktiv në shqyrtimin e çështjeve të dala nga auditimi dhe të nxitë përmirësimin e aktiviteteve operative dhe financiare të komunës. Gjithashtu, Komiteti i Auditimit të hartoj statutin ku specifikohet fushëveprimi dhe objektivat, dhe mbi këtë të bëjë një plan pune ku do t'i përcaktoj agjendat e punës dhe temat që do t'i trajtoj gjatë vitit.

## 3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

### 3.1 Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të Qeverisjes të përmendura në kapitullin 2, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve. Si pjesë e kësaj ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

### 3.2 Konkluzioni për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

Për komunën, prokurimi mbetet shqetësim i madh, ku nuk janë duke u zbatuar rregulloret duke rezultuar në vlerë të dobët të arritur për para si dhe dobësi në mbikëqyren e projekteve kapitale. Fushat tjera ku nevojiten më shumë përmirësime janë të hyrat nga dhënia me qira e pronës komunale, lejet e ndërtimit, si dhe vendosja e kriterëve të matshme me rastin e subvencionimit. Kontrollët mbi të hyrat nga tatimi në pronë në përgjithësi janë të mira dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive.

### 3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit

Ne kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për komunën, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike si dhe të hyrat e arkëtuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>1</sup>	2015 Shpenzimi	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>12,399,254</b>	<b>13,775,572</b>	<b>13,186,023</b>	<b>12,035,270</b>	<b>11,269,304</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	11,056,918	11,279,646	11,230,564	11,011,614	10,156,396
Të bartura nga viti paraprak <sup>2</sup>	-	1000,335	970,102	353,095	232,968
Të hyrat vetjake <sup>3</sup>	1,342,336	1,453,652	943,666	664,950	822,940
Donacionet e brendshme	-	-	-	5,611	-
Donacionet e jashtme	-	41,939	41,691	-	57,000

Buxheti final, krahasuar me buxhetin fillestar, është më i lartë për 1,376,318€. Kjo rritje është rezultat i vendimit të qeverisë për pagesën e përvojës së punës në shumën prej 222,724€, të hyrat e

<sup>1</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

<sup>2</sup> Të hyrat vetanake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

<sup>3</sup> Të hyrat komunale të planifikuara dhe të mbledhura në vitin aktual të përdorura për vetëfinansim.



bartura nga viti i kaluar 1,000,335€, tejkalimi i planit tek të hyrat vetjake 111,320€ si dhe donacioneve të jashtme 41,939€.

Në vitin 2015 komuna ka shpenzuar 96% të buxhetit final. Nëse krahasojmë me vitin 2014 ku buxheti ishte shpenzuar 91%, atëherë kjo mund të konsiderohet një performancë shumë e mirë e ekzekutimit buxhetor.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Shpenzimi	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>12,399,254</b>	<b>13,775,572</b>	<b>13,186,023</b>	<b>12,035,270</b>	<b>11,269,304</b>
Pagat dhe Mëditjet	8,297,000	8,549,845	8,538,950	7,801,403	6,738,235
Mallrat dhe Shërbimet	956,030	1,254,749	1,097,283	935,195	815,574
Shërbimet komunale	198,390	227,435	223,976	236,323	204,747
Subvencionet dhe Transferet	157,000	208,731	204,472	203,586	179,550
Investimet Kapitale	2,790,834	3,534,812	3,121,342	2,858,763	3,331,198

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Ndryshimi tek kategoria e pagave dhe mëditjeve prej buxhetit fillestar në atë final është 252,845€. Kjo, për arsyen se Qeveria e Kosovës ka marrë vendim për pagesën e përvojës së punës në shumë prej 222,728€. Po ashtu, te kjo kategori kishte ndryshim të të hyrat e bartura mes buxhetit final dhe atij fillestarë në vlerë prej 30,117€.
- Te kategoria e mallrave dhe shërbimeve kemi rritje të buxhetit final në krahasim me atë fillestar për 298,719€. Kjo rritje është ardhur si rezultat i hyrave vetjake të bartura në shumë 288,763€, si dhe nga donacionet e jashtme 9,956€;
- Te Subvencionet dhe transferet kemi rritje të buxhetit final nga ai fillestar për 51,731€, si rezultat i të hyrave të bartura nga viti i kaluar; dhe
- Te investimet kapitale edhe pse ka pasur rritje të buxhetit final në raport me atë fillestar për 743,978€, komuna ka shpenzuar 88%, një performancë që ka nevojë të përmirësohet.

**Tabela 3. Të hyrat vetjake në buxhetin e komunës – pranimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Pranimet	2014 Pranimet	2013 Pranimet
Të hyrat vetjake	1,342,336	1,342,336	1,453,652	1,623,310	1,202,414

Nga tabela më lart shihet se komuna kishte tejkalluar planin e të hyrave për 8%, që mund të konkludojmë se ishte një performancë e mirë e organizatës në këtë fushë.

## Çështja 6 - Realizimi i buxhetit - Prioriteti i Lartë

- E gjetura** Ekzekutimi i buxhetit në nivel të përgjithshëm ishte në shkallë të lartë, mirëpo brenda kategorive ekonomike ka pasur ngecje sidomos te investimet kapitale (88%), dhe mallrat dhe shërbimet (87%), një performancë që ka nevojë të përmirësohet. Arsyet të cilat kanë ndikuar tek një realizim i tillë kanë qenë se të hyrat që janë realizuar në muajt nëntor dhe dhjetor nuk kanë mundur të shpenzohen për shkak të mbylljes së afatit për zotime, si dhe për disa projekte punët nuk kanë mundur të kryhen gjatë vitit 2015 dhe njëherit nuk janë paguar.
- Rreziku** Ekzekutimi i buxhetit tek investimet kapitale dhe mallrat dhe shërbimet në nivelet aktuale mund të rezultojë me mos arritjen e objektivave maksimale të organizatës dhe financimin e detyrimeve të vitit aktual nga buxheti i vitit 2016.
- Rekomandimi 5** Kryetari duhet të monitorojë në mënyrë sistematike performancën buxhetore, si të hyrat, ashtu edhe shpenzimet brenda kategorive ekonomike, dhe të identifikojë dhe adresojë me kohë barrierat për ekzekutimin maksimal të buxhetit.

## 3.4 Prokurimi

Shpenzimet e prokurimit gjatë vitit ishin 3.2 milionë euro. Rregullat e Prokurimit synojnë të sigurojnë se fondet publike përdoren në mënyrë transparente dhe efikase për të arritur vlerën për para. Korniza ligjore përcakton qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në menaxhimin e prokurimit. Kjo përfshin kërkesën për të ulur rrezikun e mos përfundimit të kontratave dhe të ekzekutimit e tyre të dobët. Kjo arrihet përmes zbatimit të një regjimi të ndëshkimeve në lidhje me performancën e dobët si dhe përmes sigurisë së ekzekutimit.

Ne kemi analizuar nëse projektet për investime kapitale kanë qenë të përfshira në PIP dhe në kornizën afatmesme të shpenzimeve. Gjithashtu, kemi rishikuar nëse ka ndodhur ndonjë ndryshim në projektet e parapara për tu realizuar gjatë vitit. Vlerësimet tona janë se nuk ka ndonjë çështje për t'u ngritur në këtë raport.

Ne gjithashtu kemi bërë edhe vlerësimin e zbatimit të procedurave dhe testet tona kanë identifikuar çështjet në vijim:

## Çështja 7 - Dobësi sistematike në prokurim - Prioritet i lartë

### E gjetura

Sipas UA nr. 1/2014 Për përgatitjen e specifikimeve teknike për kontratat për punë, autoriteti kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit dhe nuk i lejohej që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkangjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit. Ne kemi vërejtur se në 8 raste komuna kishte nënshkruar kontrata për punë pa projekte ekzekutive.

Në dy kontrata për projekte kapitale, kemi vërejtur që komuna nuk kishte aplikuar ndëshkimet për kontraktuesit që kishin pasur vonesa në realizimin e planit dinamik të punimeve.

Në pesë (5) raste, te projektet e realizuara kemi vërejtur ndarje jo të duhur të detyrave tek organi mbikëqyrës. Zyrtari i cili ka përgatitur paramasën dhe paralogarinë, i njëjti është caktuar menaxher i kontratës (mbikëqyrës i punimeve), si dhe në fund e ka lëshuar çertifikatën e përdorimit (pranimin teknik të punimeve). Kryerja e gjithë procesit nga i njëjti person mund të krijojë konflikt interesi, dhe ky veprim është në kundërshtim me Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik (pika 56.3.4).

Duke u bazuar në listën e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2015, kemi identifikuar që ishin lidhur 17 aneks kontrata nga gjithsejtë 48 kontrata bazë që kanë qenë të nënshkruara për investime kapitale. Numri i lartë i lidhjes së aneks kontratave ka ardhur si rezultat i mos planifikimit adekuat të paramasës dhe paralogarisë dhe në mungesë të projekteve kryesore.

Në dy raste zyra e prokurimit nuk e kishte përgatitur dosjen e tenderit sipas paramasës dhe paralogarisë të kërkuara nga njësia kërkuuese. Te dosja e tenderit për "Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Magurë me vlerë 83,696€" kishte zvogëluar paramasën dhe paralogarinë ndërsa te Asfaltimi i rrugëve "Sillovi-Smallushë" në vlerë 82,863€ kishte shtuar një pozicion të ri. Këto ndryshime ishin bëra pa ndonjë arsyetim dhe pa aprovimin e ZKA-së.

Te kontrata "Rregullimi i trotuareve në fshatin "Gadime e epërme - Gadime e ulët" me vlerë 165,500€, ekipi i auditimit së bashku me menaxherin e projektit ka bërë ekzaminim fizik dhe ka konstatuar se pozicioni (19) furnizimi dhe punimi i murit të betonit të armuar rrjetë ø10 dy shtresa h=100cm, t=30cm në vlerë prej 7,920€, ishte paguar por nuk ishte përfunduar nga ky operator. Komuna kishte një marrëveshje bashkëfinancimi për ndërtimin e shtratit të lumit në Gadime ku në këtë projekt ishte paraparë dhe përfunduar muri mbrojtës që e kemi cekur më lartë. Mbikëqyrësi i projektit pohon se komuna ka bërë zëvendësim për këtë pozicion me ndërtimin e trotuareve, mirëpo neve nuk na është ofruar dëshmi të dokumentuara për këto ndryshime.

Te kontrata "Ndërtimi i rrethojës së SHFMU Ernes Koliqi në Babush paralelja e ndarë në Gadime të ulët" me vlerë 17,234€, kemi identifikuar pozicione që ishin pranuar dhe paguar jo në përputhje me paramasën dhe para llogarinë. Sipas paramasës pozicioni 9 furnizimi dhe vendosja e gypave ø400mm nga betoni së bashku me rërë që shërben për mbështjellje në gjatësi prej 3 metra \* 13€/metër = 39€, kemi identifikuar se vendosja e gypave ishte e metalit të ndryshkur dhe jo të betonit siç kërkohet me kontratë. Tek pozicioni numër 10 vendosja e gypave ø200mm nga betoni së bashku me rërë që shërben për mbështjellje të gypave prej 4 metra\*10/metër =40€, ne kemi konstatuar se ishin vendosur gypa të plastikës, e jo të betonit siç ishte paraparë në kontratë. Tek pozicioni numër 5 furnizimi dhe montimi i derës lëvizëse me lëvizje paralele nëpër binarë me lartësi 1.8 metra dhe gjatësi prej 4.5 metra, me vlerë 280€, kemi vërejtur se lartësia ishte 1.4 metra, e jo siç parashihej me kontratë 1.8 metra. Këto pozicione ishin paguar sipas kontratës dhe paramasës dhe parallogarisë me dosje të tenderit dhe sipas situacionit për punët kryer të pranuar nga mbikëqyrësi i projektit.

Gjatë ekzaminimit fizik të punëve në terren për kontratën "Ndërtimi i rrethojës në shkollën "Ismail Luma" në Lipjan" kemi vërejtur pozicione që ishin pranuar dhe paguar jo në përputhje me paramasën dhe parallogarinë. Pozicioni nr. 6 "Furnizimi dhe montimi i rrethojës së oborrit nga metali" sipas paramasës dhe parallogarisë është dashtë të jetë 260m, ". Gjatë ekzaminimit fizik kemi identifikuar se ajo ishte ndërtuar në gjatësi 248m. Te pozicioni nr. 4, "Furnizimi dhe betonimi i themelit" kemi vërejtur se armatura e vendosur në zogël ishte vendosur ø 10 e jo ø 12 siç kërkohet me paramasën dhe parallogariën.

#### **Rreziku**

Rastet e mësipërme tregojnë për dobësi në procesin e prokurimit. Prania e dukurive të tilla gjatë planifikimit dhe ekzekutimit nuk është në pajtim me rregullat e prokurimit.

Po ashtu, mbikëqyrja jo e duhur nga organi mbikëqyrës dhe pagesa e ekzekutuar në tërësinë e shumës së kontraktuar, duke krahasuar me punët të pranuar, reflekton në dëmtimin financiar të buxhetit të komunës.

#### **Rekomandimi 6**

Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një shqyrtim për të përcaktuar pse në rastet e mësipërme kërkesat e prokurimit nuk janë zbatuar me konsistencë. Rrjedhimisht, duhen vendosur kontrole të shtuara tek mbikëqyra e projekteve në mënyrë që punimet të kryhen sipas paramasës dhe parallogarisë së kontraktuar.

## Çështja 8 - Dobësitë jo-sistematike të prokurimit - Prioritet i lartë

**E gjetura** Në kontratën “Mirëmbajtja dhe zgjerimi i softuerit për programin e kontabilitetit”, vlera 6,900€, është shpërblyer me kontratë ofertuesi i papërgjegjshëm. Njëri nga kriteret e vendosura në dosje të tenderit ishte që operatori ekonomik (OE) nuk është me vonesë në pagesën e tatimeve. kompania fituese nuk kishte përmbushur këtë kërkesë, pasi që në vërtetimin që e kishte prezantuar në dosje ceket se ka obligime ndaj administratës tatimore.

Në kontratën publike kornizë “Furnizim me material zyrtar” llot 1, njësitë kërkuese kishin planifikuar sasi të nevojshme për material zyrtar dhe i kishin dërguar tek zyra e prokurimit, ndërsa kur është bërë shpallja publike, në dosje të tenderit ishte vendosur/kërkuar vetëm çmimi për njësi e nuk janë kërkuar sasi të cilat kanë qenë të planifikuara.

Numri i madh i prokurimeve të realizuara përmes procedurave me vlerë minimale, është tregues i dobët i planifikimeve të prokurimit duke iu shmangur aplikimeve përmes procedurave të hapura. Në listën e kontratave të nënshkruara vërejmë që komuna ka zhvilluar një numër të madh të procedurave të prokurimit në vlerë të vogël apo blerje nën 10,000€ dhe vlera minimale nën 1,000€. Gjatë vitit 2015 janë zhvilluar 10 procedura të prokurimit për blerjen e tonerëve në vlera minimale që në total arrijnë vlerën 4,242€. Gjithashtu, edhe për furnizimin me drunjë për nevojat e shkollave janë zhvilluar 3 procedura të prokurimit si: në vlerë minimale 985€, vlerë e vogël 8,050€ dhe vlerë e mesme 80,892€.

**Rreziku** Rastet e identifikuara më lartë tregojnë për kontrole të dobëta tek procesi i prokurimit. Si rezultat i procedurave të dobëta të prokurimit ka rezultuar me përzgjedhjen e ofertuesve të papërgjegjshëm, planifikim jo i mirë i prokurimeve, duke aplikuar procedura jo adekuate të prokurimit Këto rrisin rrezikun që komuna të mos fitoj vlerën e duhur për para..

**Rekomandimi 7** Kryetari duhet të shqyrtojë pse kërkesat e prokurimit nuk janë zbatuar me konsistencë në rastet e mësipërme, dhe të ushtrojë më shumë kontrole për të siguruar që situata të tilla nuk do të përsëriten.

### 3.4.1 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Buxheti i planifikuar për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte 8,549,845€, ndërsa shpenzimet 8,538,950€ apo 99%.

Ne testuam pajtueshmërinë e listave të pagave, rekrutimet, largimet, pushimet e lehonave, pensionet, dhe pagesat për anëtarët e Kuvendit Komunal. Po ashtu, kemi rishikuar nëse punonjësit janë paguar sipas kontratës.

#### Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.4.2 Subvencionet dhe Transferet

Në vitin 2015 komuna ka bërë ndarjen e subvencioneve për entitete publike dhe jo publike. Nga kjo kategori kemi testuar pagesat dhe kemi rishikuar nëse këto janë bërë në përputhje me rregulloren e ndarjes të subvencioneve. Disa nga mangësitë janë prezantuar më poshtë:

---

#### Çështja 9 - Mungesa e dëshmive me rastin e përzgjedhjes së përfituesve - Prioritet i lartë

**E gjetura** Kryetari përmes dy vendimeve të nxjerra ( më 15.07.2015 në vlerë 2,000€ dhe tjetri me datën 10.12.2015, po ashtu në vlerë 2,000€), të cilat janë transferuar në llogari të Kryqit të Kuq të Kosovës, për t'i mbështetur dy projekte me qëllime të njëjta njërin për 20 familjet nevojtare me pako ushqimore në vlerë prej 100€/familje, ndërsa projekti tjetër ka qenë po ashtu për t'i mbështetur 40 familjet nevojtare me pako ushqimore në vlerë prej 50€/familje. Ekziston një listë që kryqi i kuq i ka përcjellë komunës me emrat e përfituesve, mirëpo nuk dihet se si është bërë përzgjedhja e këtyre familjeve nevojtare për të dy rastet.

Buxheti për vitin 2015 në shumë 17,315€ ishte shpenzuar përmes drejtorisë së bujqësisë për persona fizikë në fushën e bujqësisë për sera, për renovim të stallave, etj. Kanë qenë kryesisht vlera të vogla nga 100€ deri në 1,000€ për secilin varësisht nga kërkesat që u janë drejtuar komunës. Me këtë rast, nuk ishte aplikuar një proces më transparent ku do duhej të bëhej njoftim publik dhe të caktohen dhe vlerësohen kriteret për përzgjedhjen e përfituesit. Këto kërkesa ishin aprovuar nga Kryetari i Komunës me vendime.

- Rreziku** Mungesat e dokumentacionit mbështetës për mënyrën e shpenzimit të mjeteve, si dhe mungesa e ofrimit të dëshmive për mënyrën e përzgjedhjes së përfituesve për pako ushqimore rritë rrezikun e shpenzimit të fondeve jo në pajtim me qëllimet e dedikuara. Po ashtu, mungesa e njoftimit publik dhe caktimit të kriterëve rrezikon konkurrencën e hapur dhe transparencën.
- Rekomandimi 8** Kryetari duhet të siguroj se do ketë raportim nga ana e përfituesve për mënyrën e shpenzimit të mjeteve si dhe subvencionimi në fushën e bujqësisë të bëhet në mënyrë të hapur duke vendosur kriterë të qarta.

### 3.5 Të Hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna në vitin 2015 ishin 1,454,651€. Zërat kryesor që përbëjnë shumat e mbledhura janë: të hyrat nga tatimi në pronë; taksa për regjistrimin e automjeteve, të hyrat nga taksa administrative, lejet e ndërtimit etj.

---

#### Çështja 10 - Tatimi në pronë - Prioritet i lartë

**E gjetura** Bazuar në të dhënat e ofruara nga softueri i tatimit në pronë, komuna për vitin 2015 kishte faturuar 16,382 obligues me vlerë 840,538€. Planifikimi ishte bërë në vlerë 513,000€, ndërsa ishte realizuar shuma prej 681,289€. Ne kemi testuar 12 mostra, ku komuna kishte lidhur marrëveshje me obliguesit tatimor për t'i kryer obligimet me këste, dhe kemi vërejtur se 5 prej tyre nuk i kishin kryer obligimet sipas marrëveshjes. Menaxhmenti nuk kishte marrë veprime konkrete për t'i detyruar që këta obligues t'ju përmbahen marrëveshjeve të lidhura me komunën.

Komuna nuk kishte arritur të kryej verifikimin e 1/3 e pronave të paluajtshme, si kërkohet me Ligjin për tatimin në pronën e paluajtshme nr. 03/L-204 dhe udhëzimin administrativ nr. 03/2011 për mbledhjen dhe regjistrimin e informatave mbi pronën dhe tatimpaguesin. Ne kemi vërejtur se komuna nuk ka arritur të azhurnoj sistemin me të dhëna, sepse ka pasur mungesa të zyrtarëve anketues në terren për verifikim të pronave.

**Rreziku** Mungesa e angazhimit të komunës për të siguruar implementimin e marrëveshjes për inkasimin e të hyrave nga tatimi në pronë ndikon që të hyrat e komunës të zvogëlohen dhe redukton mundësinë e realizimit të projekteve potenciale me vetëfinancim.

Mos verifikimi i 1/3 të pronave mund të rezultojë me mangësinë e informatave të plota të pronës së tatueshme aktuale, me ndikimin e mundshëm që të hyrat e vlerësuara për tatimin në pronë të ulen.

**Rekomandimi 9** Kryetari duhet të siguroj një rishikim të sistemeve ekzistuese për të konfirmuar nëse mekanizmat që ka vendosur për mbledhjen e të hyrave mund të funksionojnë në mënyrë efektive. Veprime shtesë ka nevojë të ndërmerren për të siguruar se tatimet mbliidhen në nivelet e parashikuara dhe verifikimi i pronave komunale duhet të bëhet siç parashihet me ligj.

#### **Çështja 11 - Të hyrat nga dhënia me qira e pronës komunale - Prioritet i lartë**

**E gjetura** Komuna për pronat e dhëna me qira gjatë vitit 2015 kishte planifikuar që të mbledhë shumën prej 60,900€, ndërsa ka arrit t'i realizoj 46,500€.

Ne kemi identifikuar pesë raste ku shfrytëzuesve të pronës komunale iu kishte skaduar kontrata në vitin 2014, dhe prej atëherë këta vazhdojnë t'i shfrytëzojnë lokalet pa kontrata valide.

**Rreziku** Shfrytëzimi i pronës komunale nga ana e qiramarrësve pa kontratë valide ndikon që të hyrat e komunës të zvogëlohen dhe redukton mundësinë e realizimit të projekteve potenciale me vetëfinancim.

**Rekomandimi 10** Kryetari i Komunës duhet të siguroj se nuk do shfrytëzohet prona komunale pa kontrata valide. Këtë duhet ta rregullojë përmes organizimit të ankandit publik sipas ligjit mbi shfrytëzimin e pronës komunale.

#### **Çështja 12 - Të hyrat nga Lejet e Ndërtimit - Prioritet i lartë**

**E gjetura** Sipas ligjit për ndërtim nr. 04/L-110 neni 21 paragrafi 3 theksohet se nëse aplikuesi ka paraqitur dëshmi për pagesën e taksës së lejes ndërtimore atëherë organi kompetent e lëshon lejen e ndërtimit. Ne kemi identifikuar se në katër raste është lëshuar leja e ndërtimit nga drejtoria e urbanizimit për ndërtim, pastaj është bërë pagesa për leje të ndërtimit nga ana e aplikuesve.

**Rreziku** Lëshimi i lejes së ndërtimit pa i kryer obligimet nga ana e aplikuesit, rrit rrezikun e mosrealizimit të të hyrave nga kjo kategori.

**Rekomandimi 11** Kryetari duhet të siguroj se para se të lëshohet leja e ndërtimit, fillimisht të kryhen të gjitha obligimet nga ana e aplikuesit të ndërtimit, e pastaj të lëshohet leja e ndërtimit.



## 3.6 Pasuritë dhe detyrimet

### 3.6.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Vlera e pasurive në fund të vitit 2015 ishte 173,287,700€. Ne kemi testuar 41 mostra për testet substanciale dhe të pajtueshmërisë dhe nuk kemi vërejtur ndonjë çështje për ta theksuar në raport.

#### Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë

### 3.6.2 Trajtimi i borxheve

Edhe në vitin 2015 menaxhimi i borxheve nga ana e komunës vazhdon të mbetet sfidë. Pasqyra e obligimeve të pakryera ndaj furnitorëve në fund të vitit 2015 ishte 1,081,000€, dhe është përfaqësues e njëjtë me borxhet e vitit 2014 (1,028,032€). Arsyeja e ekzistencës dhe bartjes së këtyre borxheve nga viti në vit është se komuna përballet me borxhe të trashëguara nga vitet paraprake (2012/13) ku ishin lidhur kontrata pa zotime të mjeteve.

---

#### Çështja 13 - Obligimet e papaguara - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Ne kemi testuar 11 fatura të papaguara me vlerë 42,980€ që janë raportuar si borxhe në Ministrinë e Financave dhe kemi konstatuar se komuna nuk i ka kryer obligimet brenda afatit të paraparë prej 30 ditë për arsye të mungesës së mjeteve.
- Rreziku** Mos kryerja e obligimeve sipas afateve të parapara me rregulloren e thesarit rritë rrezikun që borxhet të rriten dhe kjo pastaj e sjellë komunën në vështirësi financiare dhe të hapen konteste gjyqësore.
- Rekomandimi 12** Kryetari duhet të siguroj se të gjitha faturat e pranuar do procedohen për pagesë brenda afatit të paraparë me rregullën e thesarit nr.02/2013, si dhe për kontratat që janë nënshkruar nga vitet e kaluara pa zotime të mjeteve të planifikoj buxhet në mënyrë që të kryhen obligimet me kohë. Ne sugjerojmë që me rastin e planifikimeve buxhetore, Kryetari i Komunës duhet ta diskutoj dhe zgjidhë këtë problem me Qeverinë, përkatësisht me Ministrinë e Financave.

## Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

**Të prioritetit të lartë** - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

**Të prioritetit të mesëm** - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar/do t'i raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

## Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të implementuara	Të adresuara por jo të implementuara	Të pa adresuara
1. Procesi i përgatitjes së PVF	Kryetari duhet të sigurojë që procesi i prodhimit të PVF-ve plotësisht adreson dobësitë e identifikuar. Deklarata e bërë nga Kryetari dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur draft PVF-të dorëzohen në Qeveri duhet të nënshkruhet vetëm pas një shqyrtimi gjithëpërfshirës nga ana e menaxhmentit në lidhje me përmbajtjen dhe saktësinë e PVF-ve.	Po		
2. Rekomandimet nga viti paraprakë	Kryetari duhet të sigurojë që plani i veprimit të përcaktojë një afat kohor konkret për adresimin e rekomandimeve të mbetura nga viti 2014 si dhe ato të këtij viti. Stafi përgjegjës dhe përcaktimi i aktiviteteve që duhet të ndërmarrën, duhet të jenë komponenta të këtij plani dhe të kenë fokus prioritar trajtimin e fushave më të rëndësishme, por duke mos injoruar edhe rekomandimet tjera. Implementimi i këtij plani duhet të rishikohet nga Kryetari i Komunës në mënyrë sistematike.		Pjesërisht	
3. Korniza Qeverisëse	Kryetari duhet të sigurohet që korniza qeverisëse aktuale është rishikuar dhe janë identifikuar hapësirat/kërkesat ligjore të pazbatuara dhe aspektet e raportimit efektiv. Përmirësimet e nevojshme, përfshirë këtu një regjistër të rreziqeve të nivelit të lartë, duhet të implementohen deri në fund të vitit 2015 dhe të monitorohet në baza tremujore.		Pjesërisht	
4. Ekzekutimi i buxhetit	Kryetari duhet të sigurohet që një vlerësim real i arsyeve në lidhje me ngecjen e ekzekutimit të buxhetit për investime kapitale, dhe mallra e shërbime është bërë, dhe të përcaktoj opsione praktike për përmirësimin e ekzekutimit për vitit 2015. Një monitorim sistematik i trendeve buxhetore do të rriste mundësitë për një performancë më efektive.	Po		

4.1 Tatimi në pronë	Kryetari duhet të siguroj një rishikim të sistemeve ekzistuese për të konfirmuar nëse mekanizmat që ka vendosur për mbledhjen e të hyrave mund të funksionojnë në mënyrë efektive., Veprime shtesë janë ndërmarr që të siguroj se tatimet mblidhen në nivelet e parashikuara. Duhet të bëhet verifikimi i pronave komunale siç parashihet me ligj.		Pjesërisht	
4.2 Të hyrat nga pronat e dhëna me qira dhe taksat e biznesit	Kryetari duhet të siguroj një analizë të thellë të kontratave mbi pronat e komunës dhe aty ku e vlerëson të arsyeshme, të vazhdoj kohëzgjatjen e kontratave në pajtim me ligjet në fuqi. Të ndaloj shfrytëzimin e pronave publike për shfrytëzuesit që nuk i shlyjnë obligimet financiare ndaj komunës. Po ashtu, të ndërmerr masa mbi inkasimin e borxheve të taksave në biznes.		Pjesërisht	
4.3 Te hyrat nën 10€	Kryetari duhet të sigurojë që deri në fund të vitit 2015 të funksionalizoj softuerin që për pagesat nën 10€ në të gjitha zyrat e gjendjes civile (ofiqaritë), i cili do të përfshinte detaje të përditësuara për pagesit.	Po		
4.4 Dobësitë sistematike në prokurim	Kryetari duhet t'i kushtoj rëndësi më të madhe planifikimit të prokurimeve dhe të siguroj se njësitë kërkuese do t'i analizojnë me kohë nevojat për blerje/furnizime dhe të njëjtat të jenë pjesë integrale e Planit vjetor të prokurimit. Praktikën e prokurimit përmes procedurave të hapura, nxitin konkurrencën dhe mundësojnë nxjerrjen e çmimeve dhe cilësisë më të mirë nga tregu. Kësi soji, fondet do të shpenzohen në mënyrë më efektive, efikase dhe ekonomike.			Jo
4.4.1 Dobësitë josistematike në prokurim	Kryetari duhet të siguroj një rishikim të arsyeve se pse kërkesat e prokurimit nuk janë zbatuar me konsistencë në rastet e mësipërme, të forcoj dhe të implementoj kontrole shtuara për të siguruar që një situatë e tillë nuk janë përsëritur.			Jo
4.4.2 Marrëveshjet për bashkëfinancim dhe pagesat tjera	Kryetari duhet të sigurojë që marrëveshjet për projektet e bashkë financuara të rishqyrtohen. Paradhëniet duhet të bëhen pos nëse është bërë rishikim rigjoroz për rreziqet e tilla.. Përveç kësaj, marrëveshjet duhet t'i reflektojnë aranzhimet kontraktuale të cilat i ofrojnë një bazë të qartë për monitorim efektiv.	Po		

4.4.2.1 Pagesat direkte nga thesari për obligimet e papaguara	Kryetari duhet të shtojë kontrollet për të siguruar që për punët apo shërbimet e kryera, pagesat të bëhen në bazë të afateve të përcaktuara kohore dhe në pajtim me rregullat financiare.			Jo
4.4.3 Kompensimet-Ndërrimi i pozitive të personelit	Kryetari duhet të siguroj që burimet njerëzore janë planifikuar në përputhje me nevojat për përmbushjen e detyrave dhe të bëjë sistemimin e të punësuarve sipas aktit për organizimin e brendshëm të administratës komunale.	Po		
4.4.3.1 Kontrolle të dobëta tek procedimi i pagesave	Kryetari duhet të siguroj hartimin e një udhëzuesi të brendshëm për menaxhim të pasurive ku qartësohen rolet dhe detyrat e zyrtarëve të caktuar të cilët duhet të kontribuojnë në përgatitjen e të dhënave për pasurinë që duhet regjistruar dhe i cili paraqet edhe kriteret për vlerësimin e kategorive të pasurive, evidencën dhe ruajtjen e tyre.	Po		
4.4.4 Subvencionet Dhënia e subvencioneve jo në pajtim me rregulloren	Kryetari duhet të siguroj që subvencionimet të realizohen në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e Rregullores me Nr. 15-400-13203 të datës 03/04/2014, për ndarjen e subvencioneve.	Po		
4.4.4.1 Mungesa e raporteve-kthyes nga përfituesit e subvencioneve	Kryetari duhet të sigurojë që përfituesit e mjeteve nga subvencionet të raportojnë për mënyrën e shpenzimit të mjeteve, ashtu siç parashihet me rregullore dhe vendime të subvencionimit.		Pjesërisht	
4.5.1 Procesi i inventarizimit të pasurive	Kryetari duhet të sigurojë se komisioni i inventarizimit të përfundojë punën e tij dhe të hartoj raport përfundimtar për ekzistencën fizike dhe shkallën aktuale të funksionalitetit/përdorimit të pasurive, dhe rezultatet e inventarizimit t'i krahasoj me regjistrat kontabël dhe të bëj korrigjimet e duhura.	Po		



4.5.2 Trajtimi i llogarive të arkëtueshme	Kryetari i Komunës duhet të inicioj një proces rivlerësimi, ku të gjitha llogaritë do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, shumave domethënëse, mundësive reale për inkasim dhe ushtrimin e masave administrative (nëse ka nevojë).		Pjesërisht	
4.5.3 Menaxhimi i dobët i borxheve	Për t'iu shmangur hapjes së kontesteve gjyqësore dhe ekzekutimit të pagesave direkte nga Thesari, Kryetari duhet të trajtoj me kujdes këtë situatë, dhe të merr masat e duhura që të planifikoj buxhetin e duhur për likuidimin e borxheve si dhe të parandaloj hyrjen në obligime të reja pa zotimin paraprak të fondeve.		Pjesërisht	
4.6 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të siguroj plan konkret ku do të përcaktoj se se do të reagoj në gjetjet dhe rekomandimet e dhëna nga auditimi i brendshëm. Çështjet e ngritura nga auditimi i brendshëm duhet të diskutohen dhe adresohen nga të gjitha nivelet e menaxhimit. Komiteti i Auditimit të hartoj statutin ku specifikohet fushëveprimi dhe objektivat, dhe mbi këtë, bëj një plan pune ku do t'i përcaktoj agjendat e punës dhe temat që do t'i trajtoj gjatë vitit.		Pjesërisht	